



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1822/2018



GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË/Departamenti për Çështje Administrative, me gjyqtaren Lirije Maksutaj, e me zyrtaren ligjor, Kaltrina Çitaku, në konfliktin administrativ të paditëses, Blerta Morina nga [REDACTED], të cilën me autorizim e përfaqëson av.Rina Kika, në Prishtinë, kundër të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë, për shkak të anulimit të vendimit, në shqyrtimin kryesor jopublik të mbajtur në prani të autorizuarit të paditëses, e në mungesë të paditurës, me dt.24.10.2019, merr këtë,

AKTGJYKIM

I.Aprovohet pjesërisht si si e bazuar kërkesëpadia e paditëses, Blerta Morina nga [REDACTED], anulohet si kundërligjshëm vendimi të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Departamenti i Regjistrimit dhe Gjendjes Civile në Prishtinë, me Nr.64-04 i dt.25.06.2018 dhe vendimi i Komunës së Gjakovës Drejtoria për Punë të Përgjithshme Administrative/Zyra e Gjendjes Civile, Nr.02-201/02-8319, i dt.26.04.2018.

II.Detyrohet, Drejtoria e Administratës së Përgjithshme e Komunës së Gjakovës, që paditesit ti bëjë korrigjimin e emrit personal, nga Blerta në Blert dhe ndërrimin e shënuesit të gjinisë, nga femer (F) në mashkull (M) ashtu që korrigjimet të evidentohen në Regjistrin Themeltar dhe Regjistrin Qëndror të Gjendjes Civile dhe në tërë përbërësit tjerë të gjendjes civile, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të këtij aktgjykimi.

III.Refuzohet pjesa e kërkesës së padisë për njojen e kompenzimit të demit-jo matrial për shkelje të së drejtës në jetë përiuate, te drjetës për trajtim të barabart dhe te drejtës në pacenueshmerisë të dinjetetit njërzorë .

IV. Secila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës.

Arsyetim

Shqyrtimi kryesor në këtë çështje juridike është mbajtur në kuptim të nenit 38.6 dhe kuptim te nenit 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në prani të paditesit, autorizuarit të tij dhe në mungesë të paditurës e ftuar në mënyrë të rregullt.

Paditesji si në padine e parshtruar në këtë gjyktë me dt.24.06.2018 pr dhe në deklarin e seancës së shqyrtimit kryesor të dhënë përmes të autorizuares se tij, ka deklaruar se mbetet pran padisë se parashtruar me arsyetimin se është tranzgjitor dhe ka kërkuar që ti ndryshohet emri nga Blerta ne Blert dhe shënuesi i gjinisë nga femëror në mashkullor, në mënyrë që ato të reflektojnë identitetin e tij gjinor.Me tutje ka theksuar se ekziston asnjë pengesë për ndërrimin e emrit sipas listës takstative të neni 18 të Ligjit për Emrin Personal, prandaj theksojnë se e paditura-ARC ska ka pasur autorizim ligjore për refuzimin e kërkesës për ndërrimin e emrit me rastin e refuzimit te ankesës dhe lenjen në fuqi të vendimit gjendjes civile në Gjakovë.

Me tutje theksojnë se refuzimit i kërkesës pran organit të shkallës së parë për ndërrimin e shënuesit të gjinisë me këtë rast e paditura ka ardhur në përfundimet e gabuara në lidhje me kërkesat ligjore për ndërrimin e shënuesit të gjinisë ku ka kërkuar raporte mjekësore për ndryshimin e përbërësit të gjendjes civile të gjinisë. Shtojne se një kërkesë e tillë është vlerësuar si shkelje e të drejtës në jetë private nga GJNDNJ në vendimin AP Garson NICOT kundër Francës. Po ashtu ARC ka shpërfillur dispozitat e ligjit për barazi gjinorë ku gjinia mashkullore përcaktohet si “cdo person që e konsideron vetën të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesore”. ARC ka shpërfill edhe dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të cilat identite gjinor e mbrojnë të personi sipas karakteristikave në çiftë së përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo. Prandaj me refuzimin e ankesës tani paditëses e paditura ka berë shkelje të drejtës në privatësi, të drejtës në pacenueshmërinë e identitetit njëjësore si dhe të drejtës për tajtim të barabart. Prandaj kërkoj nga gjykata që pas shqyrtimit të thënjeve të padisë si dhe provave të bashkangjitura të nxjerr aktgjykim meritor me të cilin e vendose këtë çështje administrative dhe aprovon padin dhe kërkesëpadinë në të gjitha pikat e parashtruara.

E autorizuari e të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme/Komisioni i Ankesave në Drejtoratin e Gjendjes Civile në Prishtinë, Avokatura Shtetërore, përmes përgjigjës në padi të dt.17.06.2019, i ka propozuar gjykatës, që pas administrimit të provave, ta refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses në tërësi si të pa bazuar, ndërsa vendimin e kontestuar, t'a lenë në fuqi, si të drejtë dhe të bazuar në ligj, me arsyetimin se vendimi është nxjerrë në përputhje me legjislacionin në fuqi .

Gjykata në seancën e shqyrtimit kryesor të dt.24.10.2019, ka bërë administrimin e provave dhe atë: vendimi dt.26.04.2018, nr.02/201/02/8319, kërkesa për ndërrimin e emrit personal e tani paditësit dt.04.04.2018, vendim nr.64/04 dt.13.06.2018 ARC, përgjigje ne padi dt.17.06.2019, [REDAKTUAR], ankesa e palës ankuese dt.29.05.2018, vërtetim, vërtetim tatimore, fatura e tatimit ne prone, vërtetim nga arkivi dt.03.04.2018, [REDAKTUAR], parashtrësia dt.09.09.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimeve të goditura me padi në përputhje me nenin 44 dhe 43.3 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pergjigjes në padi e ku ka gjetur së kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Me vendimin e të paditurës, Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave në Drejtoratin e Gjendjes Civile në Prishtinë, me Nr.64-04 i dt.25.06.2018 është refuzuar ankesa e paditëses, Bleta Morina nga [REDAKTUAR] dhe ka mbetur në fuqi vendimi i Zyrës së Gjendjes Civile në Gjakovë Nr.02-201/02-8319, i dt.26.04.2018.

Paditësja e pakënaqur me këto vendime, me dt.24.06.2017, ushtron padi në Gjykatë, duke e kontestuar ligjshmërinë e tyre.

Nga vendimet e goditura rrjedhë se ato përmbajnë të meta të tilla për shkak të të cilave nuk mund të shqyrtohet ligjshmëria e tyre. Të metat e tilla qëndrojnë në shkeljet thelbësore të dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031. Shkeljet thelbësore të këtyre dispozitave konsistojnë në faktin se me nenin 48 të këtij ligji është paraparë se “1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse

është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim. 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”. Vendimet e kundërshtuara janë juridikisht të pa qarta dhe kundërthënës me vetveten dhe me arsyetimin e tyre. Në arsyetimin e tyre nuk janë dhënë arsye mbi faktet vendimtare që kanë kushtëzuar marrjen e vendimeve të kundërshtuara.

Në arsyetimin e vendimit të organit të shkallës së dytë, Ministria e Punëve të Brendshme-Komisioni i Ankesave në Drejtoratin e Gjendjes Civile në Prishtinë, është dhënë një formulim i përgjithshëm dhe abstrakt ku thuhet se “Komisioni për shqyrtimin e ankesave me rastin e vendosjes ankesës pasi ka administruar të gjitha provat ka ardhur ne përfundim se ankuesja ska argumentuar dhe mbështetur se e ka të drejtën e ndërrimit të emrit personal dhe ndërrimit të gjinisë në Regjistrin Qendror të Gjendjes Civile. Prandaj është ka mbetur ne fuqi vendimi i Zyrës se Gjendjes Civile, Nr.02-201/02-8319, i dt.26.04.2018 i bazuar në nenin 12 të Ligjit për Emrin Personal nr.02/L-118, nenit 11 dhe 32 të Ligjit për Gjendjen Civile, Nr.04/L-003 si dhe UA të MPB-se, nr.19/2015 për kushtet dhe procedurat për ndërrimin dhe korrigjimin e emrit personal”.

Për të vendosur lidhur me kërkesëpadinë e paditëses, gjykata iu referua Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit, 23, i cili përcakton se “Dinjiteti i njeriut është i pacenueshëm dhe është bazë e të gjitha të drejtave dhe lirive themelore të njeriut”. Ndërsa neni 24, përcakton se “1.Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim. 2.Askush nuk mund të diskriminohet në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, fesë, mendimeve politike ose të tjera, prejardhjes kombëtare a shoqërore, lidhjes me ndonjë komunitet, pronës, gjendjes ekonomike, sociale, orientimit seksual, lindjes, aftësisë së kufizuar ose ndonjë statusi tjetër personal. 3 Parimet e mbrojtjes së barabartë ligjore nuk parandalojnë vënien e masave të nevojshme për mbrojtjen dhe përparimin e të drejtave të individëve dhe grupeve që janë në pozitë të pabarabartë. Masat e tilla do të zbatohen vetëm derisa të arrihet qëllimi për të cilin janë vënë ato”. Kurse neni 53, përcakton se “Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

Kjo gjykatë i'u referua edhe Ligjit Nr.02/L-118 për Emrin Personal, neni 12, i cili rregullon, mënyrën e ndërrimit të emrit personal, ku përcaktohet se “Qytetari i moshës madhore mund ta ndërrojë emrin personal në bazë të kërkesës së tij”. Ndërsa neni 18 i të njëjtit ligj, i cili rregullon, pengesat për ndërrimin e emrit personal, përcakton se “18.1. Qytetari kundër të cilit zhvillohet procedura për vepër penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare i cili është dënuar për vepër të këtillë penale, derisa nuk i është ekzekutuar dënimi ose gjithnjë derisa të vazhdojnë pasojat juridike të dënimit, si dhe as personit për të cilin konstatohet se kërkesën e ka paraqitur për t’iu shmangur detyrimeve të përcaktuara me ligj, nuk do t’i lejohet ndërrimi i emrit personal. 18.2. Nëse emri personal i është ndërruar qytetari, kundër të cilit zhvillohet procedura penale për vepër penale, zyra e gjendjes civile që në afatin prej tre ditësh pas aprovimit të ndërrimit duhet ta njoftojë gjykatën në të cilën zhvillohet procedura penale. 18.3. Zyra e regjistrimit civil mund te kërkoj nga Gjykata dhe Prokuroria verifikimin e vërtetësisë te të dhënave të parashtruara nga aplikuesi lidhur me dokumentet nga neni 17 i këtij ligji. 18.4. Nëse emri personal është ndërruar me kërkesë të palës në procedurë administrative të organit të gjendjes civile, për pesë vitet e ardhshme, palës nuk do t’i lejohet sipas së njëjtës procedurë ndërrimi i serishëm i emrit personal nga organi i gjendjes civile”.

Po ashtu gjykata iu referuan edhe Ligjit Nr.05/L-020, për Barazi Gjinore, nenit, 3, i cili sqaron se shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këtë kuptim: “3.1.3. Mashkull-përfshin çdo person qe konsideron veten si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor;1.8. Gjinia- nënkupton role të krijuara shoqërore të cilat i atribuohen femrave dhe meshkujve, që është identiteti i fituar që mësohet, pëson ndryshime me kalimin e kohës dhe ndryshon përgjithësisht brenda dhe ndërmjet kulturave; 1.9. Identiteti gjinor-kjo karakteristikë e mbrojtur mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi dukjen apo karakteristikat tjera që lidhen me gjininë e një personi (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo) duke mos marrë parasysh seksin qe personi e ka pasur në lindje”.

Gjithashtu Gjykata i'u referua edhe Udhëzimin Administrativ te MPB-se, Nr.19/2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, nenit 5, të të njëjtit i cili rregullon, kriteret për ndërrimin e emrit personal për shtetasit e moshës madhore, ku përcaktohet se “5.1. Shtetasi i Republikës së Kosovës i moshës madhore mund ta ndërroj emrin personal në bazë të kërkesës së tij, nëse i plotëson kriteret si në vijim:1.1. Nëse kërkesa për ndërrimin e emrit personal bëhet vetëm nga pala personalisht, ndërsa për fëmijën prindi ose kujdestari;1.2. Nëse kërkesa për ndërrimin e emrit personal nuk ka karakter fyes, imoral, racist, ose nëse nuk është në kundërshtim me të drejtat dhe liri të e njerëzve të tjerë, apo të vet personit;1.3. Nëse kanë kaluar pesë (5) vite nga ndërrimi i fundit i emrit personal sipas nenit 18, paragrafit 4 të Ligjit nr.02/L-118 për Emrin Personal;1.4. Nëse qytetari kundër të cilit zhvillohet procedurë për vepër penale për të cilën ndiqet sipas detyrës zyrtare i cili është dënuar për vepër të këtillë penale, ndërsa nuk i është ekzekutuar dënimi ose gjithnjë derisa të vazhdojnë pasojat juridike të dënimit, si dhe as personit për të cilin konstatohet se kërkesën e ka paraqitur për t'u shmangur detyrimeve të përcaktuara me ligj, nuk do t'i lejohen ndërrimi i emrit personal”. Ndërsa neni 6 rregullon, arsyet për ndërrimin e emrit personal ku përcaktohet se “6.1. Shtetasi mund ta bëjë ndërrimin e emrit personal për arsyet si në vijim:1.8. Emri personal e pengon integrimin e personit në shoqëri”.

Me provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe atë, vendimi dt.26.04.2018, nr.02/201/02/8319, kërkesa për ndërrimin e emrit personal e tani paditësit dt.04.04.2018, vendim nr.64/04 dt.13.06.2018 ARC, përgjigje ne padi dt.17.06.2019, [REDAKTUAR], ankesa e palës ankuese dt.29.05.2018, vërtetim, vërtetim tatimore, fatura e tatimit ne prone, vërtetim nga arkivi dt.03.04.2018, [REDAKTUAR], parashtrësia dt.09.09.2018, gjykata vërteton faktin se paditësja, i ka përmbushur kriteret nga neni 5 të Udhëzimin Administrativ (MPB) Nr.19.2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, po ashtu nuk ekzistojnë pengesat për ndërrimin e emrit personal nga neni 18 të Ligjit Nr.02/L-118 për Emrin Personal, gjithashtu i ka përmbushur edhe kërkesat nga neni 1,1.3, 1.8 dhe 1.9 i Ligjit Nr.05/L-020, për Barazi Gjinore, neneve 23, 24 dhe 53 të frymës së Kushtetutës së Republikës së Kosovës, për ndërrimin e gjinisë.

Gjykata vlerëson se e paditura me rastin e refuzimit të kërkesës së paditëses për ndërrimin e emrit të tij, nga Bleta ne Blert dhe të shenuesit të gjinisë nga femër në mashkull, bënë cenimin e të drejtës së saj për privatësi nga neni 8 i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njëriut dhe nenit 36 të Kushtetutës së Kosovës, pasi që e paditura ka mohur të drejtën që ti njihet emri me indentitetin e saj gjinor. E drejta në mbrojtjen e identitetit gjinor mbrohet brenda të drejtës së privatësisë sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ.

Sipas praktikës së GJEDNJ koncepti i të drejtës në jetë private është term i gjerë dhe nuk mund të kapet në një përkufizim të ngushtë, ai përfshinë integritetin fizik dhe psikik të një personi dhe ndonjëherë mund të përfshijë edhe aspekte të identitetit fizik dhe social, elemente të tilla si për shëmbull, identifikimi gjinor, emri orientimi seksual dhe jeta seksuale hyjnë brenda sferës personale të mbrojtura me nenin 8 të konventës. Dhe duke qenë se në vetë esencën e KEDNJ qëndron respekti për dinjitetin e dhe liritë njerëzore, e drejta e personave transgjinor në zhvillim personal, siguri fizike dhe morale është e mbrojtur nga konventa.

Po ashtu dhe sipas 3.1.3. të Ligjit për Barazi Gjinore përcaktohet se “Mashkull-përfshin çdo person që konsideron veten si të tillë pavarësisht moshës dhe statusit martesor”. Ndërsa paragrafi, 1.8, i të njëjtit nen përcakton se “Gjinia-nënkupton role të krijuara shoqërore të cilat i atribuohen femrave dhe meshkujve, që është identiteti i fituar që mësohet, pëson ndryshime me kalimin e kohës dhe ndryshon përgjithësisht brenda dhe ndërmjet kulturave”. Pra me këtë definicion nuk është me rëndësi përcaktimi i seksit që një person ka pasur në lindje, por me rëndësi është vetëm përcaktimi subjektiv i gjinisë apo gjinia të cilën personi e konsideron si të vetën. Ku neni 2 paragrafi 1 i të njëjtit ligj përcakton se “Ky ligj vlen për meshkujt, femrat dhe personat që kanë një karakteristikë të mbrojtur të identitetit gjinor apo të seksit, si dhe garanton mundësi dhe trajtim të barabartë, në sferën publike dhe private të jetës shoqërore, duke përfshirë jetën politike dhe publike, punësimin, arsimin, shëndetësinë, ekonominë, përfitimet shoqërore, sportin, kulturën dhe sferat tjera të përcaktuara me këtë ose ndonjë ligj tjetër”. Ndërsa identiteti gjinor përcaktohet sipas nenit 3.1.9 të të njëjtit ligji i cili përcakton se “Identiteti gjinor-kjo karakteristikë e mbrojtur mbulon identitetin që ka të bëjë me gjininë e një personi dukjen apo karakteristikat tjera që lidhen me gjininë e një personi (qoftë përmes ndërhyrjes kirurgjike apo jo) duke mos marrë parasysh seksin që personi e ka pasur në lindje”. Në këtë çështje, ky ligj e derogon Ligjin për Gjendjen Civile në këtë çështje, për faktin se i njëjti ligj, ka hyrë në fuqi në vitin 2015 ndërsa Ligji për Gjendjen Civile është nxjerrë në vitin 2011.

Kjo gjyktë me rastin e vendosjes së çështjes së paditesës pati parayesh shkeljet e konstatuara në vendimin në rastin Christine Goodwin kundër Mbretërisë së Bashkuar Grand Chamber) ku GJEDNJ sipas kërkesës nr.28957/95 (2002) në këtë rast ka theksuar se “Duhet pranuar se mund të krijohet ndërhyrje serioze në jetën private kur gjendja e ligjit të brendshme bie në konflikt me një aspekt të rëndësishëm të identitetit, ko për arsye “stresi dhe tjetërsimi” të cilat rrjedhin prej në mospërputhje ndërmjet pozitës në shoqëri të adoptuar nga një transeksual pas operimit dhe statusit të imponuar nga ligji që refuzon të njohë ndryshimin në gjini, nuk mund të shihet si një shqetësim i parëndësishëm që rrjedhë prej një formaliteti, përkundrazi krijohet një konflikt ndërmjet realitetit shoqëror dhe ligjit që e vë transeksualin në një pozitë të çrregullt, në të cilën ai ose ajo mund të përjetojë ndjenja të cënueshmërisë, poshtërimit dhe ankthit”. Po ashtu GJEDNJ në vendimin AP Garson NICOT kundër Francës kishte theksuar se kërkimi i raporteve mjekësore për ndryshimin e përbërësit të gjendjes civile të gjinisë permban shkelje të drejtës në jetë private si në si pikat e atij vendimi.

Prandaj dhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate identiteti gjinor është karakteristikë që gëzon njohje dhe mbrojtje ligjore me apo pa ndërhyrje kirurgjike, pa marrë parasyshë seksin që personi ka pasur në lindje. Pra është e çartë se legjislacioni i Kosovës e ka futur në Ligjin për Barazi Gjinore, konceptin e njohjes së identitetit gjinor të personit edhe pa ndërhyrje kirurgjike, që është njëkohësisht në përputhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ, e cila është praktikë mbizotëruese për interpretimin e të drejtave të njeriut në Kosovë, sipas nenit 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e të paditurës të dhëna në përgjigje në padi, se me rastin e refuzimit të ankesës si e pabazuar ka vepruar në përputhje me dispozitat e Ligji për Gjendjen Civile Nr.04/L-003 repektivisht neni 11 i cili percakton se "Lindja, koha e lindjes, gjinia, amësia dhe vdekja, vërtetohen rregullisht si fakte juridike, nga personat dhe organet të cilëve iu njihet kjo e drejtë, në përputhje me legjislacionin në fuqi" si dhe bazuar nënin 32 i tij ku thuhet se "1. Lindjet si fakt, kohë, vend, gjinia dhe amësia vërtetohen me raport mjekësor ose procesverbal, të hartuar në kohën e lindjes, i cili vërtetohet nga personeli mjekësor i pranishëm, si dhe përgjegjësi i trenit, kapiteni i anijes ose i aeroplanit në udhëtim, drejtuesi i burgut, organi i rendit publik, apo zyrtarë të përfaqësive diplomatike jashtë shtetit, në mungesë të personelit mjekësor". Por të njëjtin pretendim gjykata e vlerëson si të pa bazuar për faktin se nga provat e admisntruara në seancën e shqyrtimit kryesor dhe ligjeve të sipërcituara, Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe praktikës së vendimve të GJEDNJ që ka mbajtur për rastet e njejta, paditësja i ka plotësuar kërkesat e ligjit për njohjen e të drejtës së kërkuar.

Mbi këto arsye gjykata e anulon vendimin e të paditurës MPB/ARC dhe aktvendimin e Zyrës së Gjendjes Civile të Gjakovës dhe paditësja i'a njohu të drejtën e ndërrimit të emrit personal nga Blerta në Blert dhe ti behet ndërrimi i shënuesit të gjinisë nga Femër (F) në Mashkull (M) si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjyktë refuzoj kërkesën e padisë për ti njohur të drejtën në demin jo-mtrail për shkelje të së drejtës në jetë përiuate, të drjetës për trajtim të barabart dhe të drejtës te pacenueshmerisë së dinjetetit njëzrorë, mirpo si të tilla keto pretendime su aprovuan si të bazuara për arsye së paditesja ska propozuar ekspertizë për të vlersura eventualisht demin shkatur por dhe se ka percizuar lartësin e vleres për të mundur që kjo gjykatë të vlersoj dhe vendosi kërkesën për kompenzimin e kërkuar.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 64 të Ligjit për konfliktet Administrative, që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Duke u bazuar në arsyet e dhëna më lart, gjykata në kuptim të nenit 5, 6, 38, 43.3, 44, 46.2 Ligjit për Konfliktet Administrative, lidhur me nenin 17 dhe 18 të Ligjit për Emrin Personal, neneve 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ (MPB) Nr.19.2015 për Kushtet dhe Procedurat e Ndërrimit dhe Korrigjimit të Emrit Personal, nenit 2.1, 3.1.3, 3.1.8, 3.1.9 të Ligjit për Barazi Gjinore dhe neneve 23, 24 dhe 53 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe praktikës së GJEDNJ, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative,
A.nr.1822/2018, dt.24.10.2019,

REPUBLIKA E KOSOVËS
Zyrtarë Dëgjor



REPUBLIKA KOSOVA

Kaltrina Citaku

VENDIMI ËSHTË I PLOTFUQISHËM
ODLUK JE PRAVNOSNAŽNA
GJYKATA THEMELORE / OSNOVNI SUD

Këshillë Juridike: kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga

Mu dita e marrjes së të njëjtit. Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.



Dani

(Signature)

Gjyqtare
Lirije Maksutaj

